



SYLLABUS I LËNDËS “E Drejta e Procedurës Penale I”

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	<u>E Drejta e Procedurës Penale I</u>
Programi:	Juridik i Përgjithshëm
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti 3, semestri V
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	7
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Armend Podvorica
Të dhënat kontaktuese:	armend.podvorica@uni-prizren.com
Përshkrimi i lëndës:	E drejta e procedurës penale (Pjesa e përgjithshme), bën pjesë në kuadër të lendeve penale e cila kontribuan në parandalimin dhe luftimin e kriminalitetit. Kjo lende bën pjesë në grupin e lendeve të obligueshme dhe ligjërohet në vitin e trete. Kjo lende ka për qëllim që të trajtojë parimet dhe institutet themelore mbi të cilat zhvillohet procedura penale.
Qëllimi i lëndës:	Qëllimi i lëndës E drejta penale procedurale I (Pjesa e përgjithshme) është që t’u ofrojë studentëve njohuri thelbësore dhe të mjaftueshme lidhur me institutet dhe parimet mbi të cilat ngrihet dhe zhvillohet procedura penale. Gjithashtu, kjo lëndë ka për synim që të analizojë rëndësinë veprimeve procedurale penale të cilat ndërmerren me qëllim të ndriçimit të veprës penale dhe zbulimit të kryesit të saj dhe shqiptimit të sanksionit penale, me qëllim të realizimit të qëllimit kryesor që ka procedura penale në luftën preventive dhe represive kundër kriminalitetit
Rezultatet e të nxënit:	Pas përfundimit të semestrit studentët do të përfitojnë njohuri bazike nga lënda E drejta penale Procedurale I (pjesa e përgjithshme) - Të formojnë konceptin se çka studion e drejta penale procedurale I ; - Të arrijnë të dallojnë objektin dhe subjektet e procedurës penale; - Të arrijnë të kuptojnë masat për sigurimin e pranisë së të pandehurit; Të arrijnë të kuptojnë rolin dhe rëndësinë që ka E drejta penale procedurale I në studimin e koncepteve që konsistojnë në studimin e veprimeve procedurale penale të cilat ndërmerren me qëllim të ndriçimit të veprës penale dhe zbulimit të kryesit të saj;



Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	3	15	45 orë
Ushtrime teorike/laboratorike	2	15	30 orë
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	0.5	15	7.5 orë
Ushtrime në terren			
Kollokfiume, seminare	0.5	15	7.5 orë
Detyra të shtëpisë			
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	3	15	45 orë
Përgatitja përfundimtare për provim	3	15	30 orë
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)			
Projektet, prezantimet ,etj			
Totali			175 orë (7 ECTS)
Metodologjia e mësimdhënies:	Prezantimi i shkurtër i temave nëpërmjet PoëerPoint, Analizimi, diskutim interaktiv, punë në grupe lidhur me rastet për studim, pyetje dhe përgjigje.		
Metodologjia e vlerësimit:	Vlerësimi I studentëve do të bëhet përmes këtyre metodave: 1.Kolokviumeve, 2.Prezantimeve, 3.Punimeve seminarike, 4.Pjesëmarrjes në diskutim, 5. Provimit perfundimtar		
Literatura			
Literatura primare:	E drejta procedurale Penale, Dr.sc. Ejup Sahiti, Dr.sc.Rexhep Murati Kodi i Procedurës penale, Prishtinë, 2016 Komentari i Kodit të procedurës penale, Prishtinë, 2014		
Literatura shitesë:	Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Prishtinë 2008 Roli i Prokurorit të shtetit në procedurën penale, Dr.sc. Hashim Çollaku, Prishtinë, 2013		



	<p>Klinika Juridiko-Penale, Dr.sc. Hashim Çollaku, Prishtinë 2016</p> <p>E drejta Procedurale Penale, pjesa e përgjithshme, Dr.sc. Azem Hajdari,</p> <p>Argumentimi në procedurë penale, Dr.sc.Ejup Sahiti, Prishtinë, 2006</p>
--	---

Plani i dizajnuar i mësimit:		
Java	Ligjërata	Ushtrime
<i>Java e parë:</i>	<ul style="list-style-type: none"><input type="checkbox"/> Prezantimi hyrës;<input type="checkbox"/> Njohja dhe qëllimi i lëndës;<input type="checkbox"/> Programi i lëndës;<input type="checkbox"/> Rezultatet e pritura;<input type="checkbox"/> Literatura;<input type="checkbox"/> Vlerësimi;<input type="checkbox"/> Politikat akademike. <p>Studentët do të njoftohen me përmbajtjen e lëndës në përgjithësi, mënyrën e zhvillimit të mësimit gjatë semestrit dhe literaturën.</p> <p>-Hyrje në lëndën E drejta penale procedurale I -objekti dhe detyrat, funksioni, aktualiteti dhe perspektiva e lëndës së E drejta penale penale procedurale I;</p>	
<i>Java e dytë:</i>	<p>E DREJTA PENALE NË KUPTIM TË GJËRË TË FJALËS DHE REGULLIMI I PROCEDURËS PENALE -</p> <p>Format e reagimit të shtetit-shoqërisë ndaj kriminalitetit;</p> <p>- Kuptimi i të drejtës penale materiale, i procedurës penale, i drejtës së procedurës penale dhe i të drejtës së ekzekutimit të</p>	

	<p>sanksioneve të procedurës penale.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Rregullimi i procedurës penale dhe realizimi i të drejtave të njeriut. 	
<i>Java e tretë:</i>	<p>ZHVILLIMI HISTORIK I TË DREJTËS SË PROCEDURËS PENALE</p> <ul style="list-style-type: none"> - Format themelore të procedurës penale. - Procedura penale akuzatore, inkuizitore dhe mikste. - Zhvillimi historik i të drejtës së procedurës penale në Kosovë 	
<i>Java e katërt:</i>	<p>RAPORTI I TË DREJTËS SË PROCEDURËS PENALE ME DEGËT TË TJERA JURIDIKE DHE ME DISA DICSCIPLINA SHKENCORE</p> <ul style="list-style-type: none"> - Raporti i të drejtës së procedurës penale me të drejtën penale materiale dhe - Raporti me të drejtën e ekzekutimit të sanksioneve penale. - Raporti i të drejtës së procedurës penale me procedurat të tjera ndëshkimore, - Raporti me të drejtën e procedurës civile dhe me disa disiplina të tjera shkencore. <p>BURIMET E TË DREJTËS SË PROCEDURËS PENALE</p> <ul style="list-style-type: none"> - Burimet e brendshme dhe burimet dhe burimet e jashtme; 	
<i>Java e pestë:</i>	<p>VLEFËSHMËRIA E DISPOZITAVE TË PROCEDURËS PENALE</p> <ul style="list-style-type: none"> - Vlefshmëria e dispozitave të procedurës penale, lidhur 	

	<p>me territorin, kohën dhe personin.</p> <ul style="list-style-type: none"> - Imuniteti sipas të drejtës së brendshme dhe të drejtës ndërkombëtare. <p>INTERPERTIMI I DISPOZITAVE TË DREJTËS SË PROCEDURËS PENALE</p> <ul style="list-style-type: none"> - Llojet e interpretimit; - Sipas subjektit ; - Sipas qëllimit; - Sipas metodës: 	
<i>Java e gjashtë:</i>	<p>PARIMET PROCEDURALO-PENALE</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kuptimi i parimeve. - Parimi i oficalitetit të ndjekjes penale, - Parimi i legalitetit në ndjekjen penale, - Parimi akuzator, - Parimi i gjykimit të drejtë dhe në kohë të arsyeshme, - - Parimi i prezumimit të pafajësisë, i të vërtetës, - Parimi kontradiktor dhe i barazisë së armëve (equality of arms), - Parimi i drejtpërdrejtë, gojor dhe i gjuhës, - Parimi publicitetit, - Parimi in dubio pro reo dhe Parimi i kompensimit të dëmit të dënuarit ose të arrestuarit pa bazë. 	
<i>Java e shtatë:</i>	<p>LËNDA (OBJEKTI) I PROCEDURËS PENALE</p> <ul style="list-style-type: none"> - Objekti themelor dhe Objekti sekondar i procedurës penale. - Format e objektit sekondar: kërkesa pasurore juridike, çështja prejudikuese dhe shpenzimet e procedurës penale. 	
<i>Java e tetë:</i>	<p>Vlerësimi i parë (intermediar)</p>	

<p><i>Java e nëntë:</i></p>	<p>PJESEMARRESIT (SUBJEKTET) NË PROCEDURËN PENALE</p> <ul style="list-style-type: none"> - Subjektet themelor: Gjykata, Prokurori dhe I pandehuri - GJYKATA, llojet dhe përbërja e gjykatave, - Parimet lidhur me rregullimin dhe organizimin e gjykatave, Kushtet që duhet të plotësohen për të ushtruar funksionin gjyqësor si edhe - Institucioni i përjashtimit të gjyqtarëve profesional dhe laik. <p>KOMPETENCA E GJYKATAVE</p> <ul style="list-style-type: none"> - Llojet e kompetencave. <p>Vlerësimi i kompetencës dhe konflikti i kompetencës. Ndihma juridike</p>	
<p><i>Java e dhjetë:</i></p>	<p>PALËT PROCEDURALO – PENALE. - PADITËSI I AUTORIZUAR.</p> <p>Prokurori publik,</p> <ul style="list-style-type: none"> - I PANDEHURI dhe mbrojtësi si ndihmës procedural i të pandehurit (p.sh. mbrojtësi i të dyshimit dhe të akuzuarit). - Subjektet të tjerë sekondar në procedurën penale: - I dëmtuari në procedurën penale, - Propozimi për ndjekje, kërkesa pasurore juridike. - Përfaqësuesit procedural të të dëmtuarit (p.sh. përfaqësuesi ligjor dhe përfaqësuesi i autorizuar), - Personat e tretë (dëshmitarët, ekspertet profesionistet etj.) dhe Ndihmësit procedural të gjykatës (procesmbajtësi, stenografistet, regjistruesi 	

	<p>teknik-xhiruesi, përkthyesit, personeli gjyqësor).</p>	
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	<p>VEPRIMI PROCEDURALO-PENAL</p> <ul style="list-style-type: none"> - Forma, vendi dhe koha e kryerjes së veprimeve procedurale, Shkresat penale- - Aktet akuzuese; - Vendimet gjyqësore. <p>Mjetet juridike të goditjes dhe parashtresat të tjera</p>	
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	<p>MASAT PËR SIGURIMIN E PRANISË SË TË PANDEHURIT PËR PENGIMIN E KRYERJES SË VEPRËS PENALE DHE PËR SIGURIM TË ZHVILLIMIT ME SUKSES TË PROCEDURËS PENALE</p> <p>Masat e drejtuara ndaj të pandehurit:</p> <ul style="list-style-type: none"> - thirrja, - urdhër arresti-shoqërimi, - premtimi i të pandehurit se nuk do ta braktis vendqëndrimin, ndalimi për t'iu afruar vendit ose personit të caktuar, - paraqitja në stacionin policor, - dorëzania, - arresti shtëpiak, - diversioni dhe - paraburgimi. 	
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	<p>MASAT PËR SIGURIMIN E PROVAVE MAERIALE DHE INTERESAVE PASURORE</p> <p>Masat për sigurimin e provave materiale</p> <ul style="list-style-type: none"> - kontrolli i banesës dhe i personit, - masat e fshehta dhe teknike të vëzhgimit dhe të hetimit, - konfiskimi-sekuestrimi i përkohshëm i sendeve dhe 	



	veprimi me sende të dyshimta dhe - masat për sigurimin e interesave pasurore.	
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	TË PROVUARIT NË PROCEDURËN PENALE - Shqyrtimet e përgjithshme përkitazi me procesin e të provuarit. - Faktet dhe vërtetimi i tyre në procedurën penale, - Kuptimi i provës, mjetet e provës, - Klasifikimi i provave, objekti i provës (thema probandi), barra e provës (onus probandi). - Provat juridikisht të pavlefshme, procedura lidhur me to dhe pasojat juridike. Studentët obligohen të zbatojnë kodin dhe sjelljen së Universitetit të Prizrenit. Çdo shkelje e dyshuar e kodit të sjelljes i referohet zyrtarëve të Universitetit për procedurë të mëtejshme. Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes: LLOJET DHE TRAJTIMI I DISA PROVAVE - Deklarimi i të pandehurit si provë në procedurën penale. Marrja në pyetje e të pandehurit. Pohimi i të pandehurit. - Dëshmia e dëshmitarit. Dëshmitarët e privilegjuar, - Mbrojtja e dëshmitarit dhe dëshmitari bashkëpunues. - EKSPERTIMI. - KQYRJA DHE RIKONSTRUKIONI - PROVAT MATERIALE	
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Vlerësimi i dytë (intermediar)	
Politikat akademike dhe kodi i sjelljes		



Studentët obligohen të zbatojnë kodin dhe sjelljen së Universitetit të Prizrenit. Çdo shkelje e dyshuar e kodit të sjelljes i referohet zyrtarëve të Universitetit për procedurë të mëtejshme.